



**Analizë e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.  
04/L-147 për Ujërat e Kosovës**

# Përmbajtja

Hyrje .....	2
Komente të përgjithshme .....	2
Komente specifike .....	3
1. Adaptimi me ndryshimet klimatike.....	3
2. Rregullimi me akte nënligjore .....	4
3. Përgjegjësitë e Ministrisë .....	4
4. Mbrojtja e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulimeve .....	5
5. Lëshimi i lejes ujore pa kushte ujore dhe pëlqim ujqor.....	5
Përfundime.....	6
Rekomandime.....	6

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka bërë analizimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës. Ky projektligj, është vendosur për konsultim publik në platformën online të konsultimeve publike. Ky punim ka për qëllim të analizoj ndryshimet kryesore të paraqitura në këtë projektligj. Është bërë si pjesë e programit të INDEP për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe është në vazhden e punës monitoruese të Institutit me qëllim të ofrimit të rekomandimeve për politika publike që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm për resurset natyrore.

Spektori i ujërave vazhdimisht përballet me presionin për të ruajtur resurset ujore në njërin anë, dhe për të ndikuar në nxitjen e zhvillimit ekonomik në anën tjetër. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës ka hyrë në fuqi në vitin 2013. Që nga ajo kohë, Ligji nuk ka pësuar ndryshime. Ky plotësim-ndryshim vjen në një kohë specifike në të cilën Qeveria është në tranzicion të ndërrimit të pushtetit nga një Qeveri në shkuarje në një Qeveri në ardhje.

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat është një një rast shumë i mirë që të diskutohen problemet kryesore që e shoqërojnë sektorin dhe për të identifikuar zgjidhjet kryesore që mund të arrihen. Për më tepër, Ujë i Pastër dhe Kanalizime është edhe një nga 17 Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 2015. Ai bën thirrje për ujë të pastër dhe kanalizime për të gjithë njerëzit. Ky Projektligj, dhe baza e përgjithshme ligjore në fushën e ujërave në Kosovë i kontribuon pikërisht implementimit të kësaj objektive.

## Komente të përgjithshme

Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës është publikuar në platformën e konsultimeve publike pa respektuar dispozitat e Rregullores Nr. 05/2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Kjo Rregullore, në nenin 9të saj, përcakton obligimin që ka Organi Konsultues që krahas dokumentit që propozon, të publikoi edhe një Dokument të Konsultimit.

Në ftesën për konsultim me shkrim, organi propozues duhet të përfshijë të paktën:

- 2.1. Projektpropozimin për të cilin kërkohen komentet;
- 2.2. Dokumentin për konsultim;
- 2.3. Adresa e saktë ku duhet të dërgohen komentet;
- 2.4. Afatin për dërgimin e komenteve;
- 2.5. Informatat mbi personin kontaktues për procesin e konsultimit publik<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, (2016), Rregullore Nr. 05/2016, për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, Prishtinë, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036> (qasur në tetor, 2019).

Në platformë mungon Dokumenti për konsultim me të ciën gjë, organi sponsorizues i këtij dokumenti ka bërë shkelje të kësaj Rregulloreje. Rrjedhimisht, duke qenë se mungon Dokumenti i Konsultimit, nuk është e qartë qëllimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 05/L-147 për Ujërat e Kosovës sepse mungon një analizë e problemit, pastaj mungojnë opsionet e diskutuara dhe se për cilat elemente organi qeveritar ka më së shumti nevojë për komente nga palët. Të gjitha këto do të mund të mbuloheshin nëse do të kishte një Dokument për konsultim siç parashihet në Rregullore.

Një numër shumë i madh i çështjeve të trajtuara në Projektligj kanë mbetur të rregullohen më tutje me akte nënligjore.

Neni 8	Rregullimi i statusit të pasurisë ujore me akt nënligjor
Neni 8b	Me vendim të ministrit përcaktohet përkatësia e pronës ujore të pronave publike ujore jashtë zonave urbane, dhe me vendim të Komunës brenda zonave urbane.
Neni 9	Ministri sjellë rregullore mbi përmbajtjen e aktit të përgjithshëm nga paragrafi 3 i nenit 41 të Ligjit bazik.
Neni 17	Rregullimi i kushteve për koncesion për shfrytëzim të pasurive ujore
Neni 71.2	Procedura për kushtet ujore, pëlqim ujqor, leje ujore dhe urdhëresë ujore

*Tabela 1. Lista e elementeve të lëna me akte nënligjore*

Rregullimi i kaq shumë elementeve me akte nënligjore për një plotësim-ndryshim të Ligjit është i dëmshëm. Edhe në të kaluarën, ne kemi kundërshtuar lënjen e çështjeve kryesore me akte nënligjore pasi vendimmarrja me akte nënligjore nuk kalon nëpër të njëjtat filtra të diskutimit sikurse diskutimi për Ligjet.

## **Komente specifike**

Ne konsiderojmë që Projektligji, qoftë edhe vetëm për shkak të mungesës së Dokumentit të konsultimit, duhet të tërhiqet nga procedura menjëherë. Megjithatë, duke trajtuar përmbajtjen e tij, ne kemi gjetur një numër të konsiderueshëm të problemeve që kjo nismë ligjore ka e për të cilat do të japim komente specifike në vazhdim:

### **1. Adaptimi me ndryshimet klimatike**

Neni 3 i projektligjit ndryshon nenin 6 të Ligjit bazik ku shtohet pika 1.13 me paragrafin:

1.13. Administrimi i ujërave adaptohet me ndryshimet globale klimatike

Ndonëse është vënë tek parimet kryesore të paraqitura në nenin 6 të Ligjit në fuqi, Projektligji askund tjetër nuk ka paraparë harmonizim të legjislacionit apo politikave me legjislacionin për ndryshimet klimatike apo sektorë të tjerë. Sidoqoftë, vendosja e këtij parimi, për ne, është një hap pozitiv që tregon përkushtimin e Ministrisë për të integruar ndryshimet klimatike në legjislacion dhe dokumente politike.

## 2. Rregullimi me akte nënligjore

Siç e theksuam edhe tek komentet e përgjithshme, për ne, lënja për t'u rregulluar me akte nënligjore e një pjese të konsiderueshme të çështjeve është praktikë e panevojshme dhe e dëmshme për transparencën dhe qeverisjen e mirë. Paragrafi 5 i nenit 8 që ka përcaktuar se “Ministri më detajisht me akt nënligjor, bën rregullimin e statusit të pasurisë ujore”<sup>2</sup>, është i panevojshëm dhe konsiderojmë që duhet hequr. Projektligji në katër paragrafët paraprak ka sqaruar mirë çështjen e statusit të pasurisë ujore dhe nuk ka nevojë që me një akt shtesë nënligjor të sqarohet më tutje. Për më tepër, statusi i resurseve natyrore në përgjithësi është rregulluar edhe me nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Një element që është dashur patjetër të rregullohet me Ligj është **“Prurja e pranueshme ekologjike”** e trajtuar në nenin 65 të Ligjit bazik.

3. Deri në fuqizimin e rregullores nga paragrafi 4. i këtij neni, prurja e pranueshme ekologjike përcaktohet në bazë të karakteristikave hidrologjike, hidraulike, habitateve për sezone karakteristike sipas metodave të avancuara standarde, si dhe sigurisë së nëntëdhjetë e pesë përqind (95%) të prurjes së mesatares mujore.

4. Ministri me akt të veçantë nënligjor nxjerr rregulloren mbi mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike.<sup>3</sup>

Projektligji në formën e tanishme, ka fshirë në tërësi paragrafin 3 të Ligjit në fuqi dhe ka lënë sërish në dorën e Ministrit që të përcaktoj nivelin e prurjes së pranueshme ekologjike. Ne konsiderojmë që përtej aspekteve teknike të kalkulimit, Ligji do të duhej të përcaktonte një nivel të prurjes i ngjashëm me atë të përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 65 të Ligjit aktual në fuqi. Kjo do të siguronte që ky nivel është përcaktuar me Ligj dhe i nënshtrohet një diskutimi të gjerë publik në vend se të jetë thjeshtë në diskrecionin e Ministrit që ta përcaktoj.

## 3. Përgjegjësitë e Ministrisë

Projektligji ka plotësuar dhe ndryshuar nenin 13 të Ligjit aktual mbi “Përgjegjësitë e Ministrisë”. Një nga përgjegjësitë e Ministrisë të përcaktuara në Ligjin aktual në fuqi është edhe bashkëpunimi me shtetet fqinje. Kjo përgjegjësi është hequr fare nga Ligji me këtë Projektligj. Ne e kundërshtojmë këtë duke e konsideruar një regres nga forma e tanishme e Ligjit. Procesi i integritimit evropian, me theks të veçantë zbatimin e kapitullit 27 të Integritimit në BE që ka të bëjë me mjedisin, kërkon bashkëpunim të shtuar me vendet e rajonit dhe koordinim të politikave. Ne vlerësojmë që projektligjit i duhet shtuar edhe paragrafi 9 me përmbajtjen në vazhdim:

“Bashkëpunimi me vendet fqinje në funksion të ndarjes së praktikave dhe harmonizimit të politikave që qojnë në integritimin evropian të Kosovës dhe rajonit”.

<sup>2</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, (2019), Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 8, paragrafi 5, faqe 7. Prishtinë.

<sup>3</sup> Republika e Kosovës, (2013), Ligji Nr. 05/L-147 për Ujërat e Kosovës, Neni 65, paragrafët 3 dhe 4, faqe 22, i qasëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>, (qasur në tetor, 2019)

#### 4. Mbrojtja e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulimeve

Projektligji shkakton një regres të theksuar në legjislacion me faktin që ndryshon nenin 48 të Ligjit aktual “Mbrojtja e brigjeve të ujëdhjedhave dhe akumulimeve” gjegjësisht paragrafin 1.3 tek i cili ndryshon distanca nga 30 metra sa ishte në Ligjin aktual në 10 metra dhe atë për ujërat e larta 100 vjeçare.

Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar:<sup>4</sup>

Ligji aktual	Projektligji
1.3. ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve;	te ngritën ndërtesa dhe objekte tjera të cilat nuk i shërbejnë mbrojtjes nga vërshimet dhe të cilat pengojnë qasjen në ujërrjedhe në distance me pak se <b>10 metra nga vija e arritjes së ujërave të larta 100 vjeçare</b> për të gjitha ujërat sipërfaqësore, përveç nëse pronarit ose shfrytëzuesit i është kushtëzuar ndërtimi objektit me ndërmarrje të masave paraprake mbrojtëse me të cilat parandalohen ose zvogëlohen e efektet e dëmshme nga ujërat.

Ne konsiderojmë që ky ndryshim është i dëmshëm dhe nuk kontribuon në mbrojtjen e ujërave. Përkundrazi, ndalimi që të ndërtohet në distancë prej 30 metrave është ashtu ashtu një distancë e vogël tashmë. Ne konsiderojmë që kjo distancë do të duhej të ndryshohej në 50 metra sipas shembullit të Maqedonisë.<sup>5</sup> Në situatën aktuale, ne konsiderojmë që ky ndryshim i pa arsyetuar është i panevojshëm dhe propozojmë heqjen e tij nga Projektligji.

#### 5. Lëshimi i lejes ujore pa kushte ujore dhe pëlqim ujqor

Projektligji ka propozuar ndryshimin e nenit 77 mbi “Procedurat e marrjes dhe pushimit të Lejes Ujqore”. Sipas këtij ndryshimi:

Përfundimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, leja ujore **mund të lëshohet pa kushte ujore dhe pëlqim të lëshuar ujore**, për objektet e ndërtuara dhe sistemet të cilat kanë leje përdorimi dhe nuk ndikojnë dëmshëm në regjimin e ujërave.<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Republika e Kosovës, (2013), Ligji Nr. 05/L-147 për Ujërat e Kosovës, Neni 48, faqe 18, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>, (qasur në tetor, 2019)

<sup>5</sup> Republika e Maqedonisë, (2015), Ligji për Ujërat Neni 131, i qasshëm në versionin anglisht në <http://www.moep.gov.mk/wp-content/uploads/2014/10/LAW-ON-WATERS.pdf> (qasur në tetor, 2019)

<sup>6</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, (2019), Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 8, paragrafi 5, faqe 7. Prishtinë.

Ne kundërshtojmë një ndryshim të tillë dhe konsiderojmë që si i tillë duhet të largohet nga Projektligji. Aktualisht, një diskutim i gjerë shoqëror është duke ndodhur në lidhje me degradimin mjedisor të ujërave të shkaktuar nga projekte të cilat kanë filluar së implementuari pa leje ujore dhe pa verifikim të dëmeve në rrjedha ujore. Nëse me projektligj lihet hapësirë që të lëshohet leja ujora pa kushte ujore dhe pëlqim ujqor, atëher rritet edhe më tutje hapësira për keqpërdorim me resurse ujore për përfitime të biznesit në dëm të mjedisit. Ne konsiderojmë që një dispozitë e tillë duhet të hiqet nga Projektligji pa shkuar në fazat e mëtejme të diskutimit.

## **Përfundime**

Projektligji është vënë në diskutim publik në kundërshtim me Rregulloren Nr. 05/2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Është publikuar vetëm Akti ligjor për konsultim dhe nuk është publikuar fare Dokumenti i Konsultimit i domosdoshëm në bazë të kësaj rregulloreje. Në këtë mënyrë, konsultës i mungon shtjellimi i problemit, çështjet kryesore të trajtuara, kostot, pikat kryesore për diskutim etj.

Projektligji ka lënë një numër të madh të çështjeve për t'u rregulluar me akte nënligjore. Trajtimi i elementeve mjaft përmbajtësore si për shembull, "prurja e pranueshme ekologjike" nga neni 11 i Projektligjit me akte nënligjore zbehë mundësinë për gjithëpërfshirje në procesin e vendimmarrjes dhe lë në diskrecion të Ministrisë çështje shumë me rëndësi për sektorin.

Projektligji me të drejtë ka theksuar ndryshimet klimatike dhe harmonizimin e politikave të ujërave me ato të ndryshimeve klimatike në nenin 6 të Ligjit bazik mbi "Parimet për administrim të qëndrueshëm" por nuk ka ndryshuar më tej asnjë dispozitë tjetër për të harmonizuar dokumentin me, le të themi, Draftin e ri të Strategjisë për Ndryshimet Klimatike.

Projektligji ka ndryshuar një element substancial të Ligjit që ka të bëjë me Mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulimeve ku distanca nga ndërtimet është shkurtuar nga 30 metra sa ka qenë në 10 metra. Kjo dispozitë nuk i kontribuon aspak mbrojtjes së brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulimeve dhe përkundrazi do të rrisë mundësinë për dëmtim të këtyre brigjeve.

Projektligji e ka bërë të mundshme që të merret leja ujore edhe pa kushte ujore dhe pëlqim ujqor. Kjo dispozitë, e vënë në nenin 16 të Projektligjit që ndryshon nenin 77 të Ligjit në fuqi i hapë rrugë degradimit të mëtejme të ujërave duke u mundësuar subjekteve të caktuara që të pajisen me leje ujore pa kushte ujore dhe pa pasur një pëlqim ujqor.

## **Rekomandime**

Të tërhiqet Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-147 për Ujërat e Kosovës deri në kompletimin e dokumenteve për vendosje në konsultim publik. Në formën aktuale, Konsulta Publike nuk plotëson kriteret për t'u vënë në konsultim publik dhe nuk ofron kushte për një qasje gjithëpërfshirëse në procesin e konsultimit.

Ministria të hartoj Projektligjin e ri dhe të njëjtit t'ia shoqëroj një Dokument të detajuar të konsultimit në të cilin sqarohen politikat prapa ndryshimeve, nevojat, kostot dhe pritshmëritë e

Ministrisë. Vetëm kështu do të ketë mundësi për debat të mirëfillt me publikun në lidhje me nevojën ose jo për ndryshimet e propozuara.

Projektligji të jetë më konkret. Niveli i prurjes së pranueshme ekologjike nga neni 11 i Projektligjit që ndryshon nenin 65 të Ligjit bazik duhet të përcaktohet me Ligj dhe jo t'i lehet në diskrecion Ministrit se çfarë niveli të përcaktoj. Përveç kësaj, edhe në pikat tjera që lihen me akte nënligjore, duhet të përcaktohen elementet kryesore në mënyrë që aktet nënligjore të mos mbulojnë aspekte përmbajtësore të ligjit por vetëm elemente teknike.

Të tërhiqet ndryshimi i bërë në nenin 48 “Mbrojtja e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulimeve” dhe nëse mbetet, distanca të ndryshohet nga 30 metra sa është në Ligjin aktual, në 50 metra. Ky ndryshim duhet bërë me qëllim të mbrojtjes së brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulimeve.

Të hiqet neni 16 i Projektligjit që ndryshon nenin 77 të Ligjit aktual. Ofrimi i mundësisë që të merret leja ujore edhe pa kushte ujore dhe pëlqim ujqor është një dispozitë që dëmton rëndë përpjekjet për mbrojtje të rrjedhave ujore dhe i ofron Ministrisë një mbulesë ligjore për të lëshuar leje ujore pa plotësim të kushteve minimale ligjore.